



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT KUKES**



**VENDIM**

Nr. 43 Date 2.11.2014

**PER MIRATIMIN E PROCEDURES SE KALIMIT TE PRONESISE SE PASURIVE  
TE PALUJTSHME TE NDERTUARA DERI ME 10.08.1991 SI DHE TE TRUALLIT  
FUNKSIONAL, PER 1 OBJEKT BANIMI, LAGJIA "SHEN GJON", KOMUNA  
FIERZE, RRETHI TROPOJE**

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pas shqyrtimit te Relacionit dhe P/Vendimit te paraqitur nga Drejtoria e PKZHT-se bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1b, 54,72, ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" te miratuar me date 21.03.2012, VKM Nr.608 date 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, për regjistrimin e tyre", kerkeses se bere nga Komuna Fierze me shkresen Nr.398 Prot. date 06.11.2014, si dhe ne vendimin e Kryesise se KQK-se Nr.23 date 21.11.2014,

**VENDOSI:**

1. Te miratoje proceduren per kalimin e pronesisë se pasurive te paluajtshme, te ndertuara deri me date 10.08.1991, si dhe te truallit funksional te tyre, per 1 (nje) objekt banimi ne lagjen "Shen Gjon" te Komunes Fierze, rrethi Tropoje, per subjektin e meposhtem:

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	ZK	Nr. Pasurie	Sip. Trualli (m2)	Sip. Ndertimi (m2)
1.	Pashk	Nik	Aliaj	1617	2/109/1	300	128

Shenim: Mbyllet me Nr. Rendor 1 (Nje)

2. Drejtoria e Teknologjise se Informacionit, Programimit dhe Statistikave (TIPS) prane Keshillit te Qarkut Kukës, për qëllime transparence, të publikojë kete vendim në faqen zyrtare të internetit si dhe në mjediset e njoftimeve publike.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit te Tokes, Drejtoria TIPS, si dhe Komuna Fierze.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

